



C.nr.644/2013

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-
Divizioni Civil**, gjyqtari Burim Emërllahu ,duke vendosur në qështjen
kontestimore të paditësit [REDACTED]
[REDACTED] ,të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë [REDACTED] nga
Ferizaji ,kundër të paditurit [REDACTED] ,nga Ferizaji tani me adres të panjohur të
cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDACTED] nga Ferizaji ,për
shkak të përmbushjes së kontratës , me datë 11.02.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohet kërkespadija e paditësit [REDACTED]
[REDACTED]-Prishtinë,me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri [REDACTED]
[REDACTED] që t'ia paguaj paditësit shumën prej 597,75 euro në emër të përmbushjes së
kontratës ,me kamatë në lartësi prej 3 %,duke filluar nga data parashtrimit të padisë
e deri në ditën e pegesës dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 15
ditësh ,nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

II.Detyrohet paditësja [REDACTED]
[REDACTED]-Prishtinë që përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit av. [REDACTED] nga
Ferizaji , t'ia paguaj shumën e të hollave prej 355.68 euro ,në emër të një
përfaqsimi ,hartimit të përgjegjjes në padi dhe ankesës.

III.Detyrohet paditësja [REDACTED]
[REDACTED]-Prishtinë që kësaj gjykate në emër të takses për padi t'ia paguaj shumën
e të hollave prej 15 euro,kurse në emër të takses gjyqësore për aktgjykim t'ia
paguaj shumën e të hollave prej 15 euro.

A r s y e t i m

Paditësja [REDACTED]
Prishtinë , ka parashtruar padi në këtë gjykatë,kundër të paditurit [REDACTED]
nga Ferizaji ,me bazë juridike përmbushja e kontratës .Paditësja me kërkesepadi ka
kërkuar nga gjykata që të obligohet i padituri [REDACTED] që t'ia paguaj paditësit
shumën prej 597,75 euro në emër të përmbushjes së kontratës ,me kamatë në lartësi



prej 3 %,duke filluar nga data parashtrimit të padisë e deri në ditën e pegesës dhe shpenzimet e procedures kontestimore në afat prej 15 ditësh ,nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Në seancë përfaqësuesja e autorizuar e paditëses [redacted] e ka njoftuar gjykatës se paditësja heq dorë nga kërkespadija ,me arsyetim se sipas ligjit per faljen e borgjiti borgjet deri ne vitin 2008 janë falur,kurse paditësja pas shikimit të evidences së saj ka konstatuar se i padituri [redacted] nu ka obligime të papërmbushura ndaj paditëses për periudhën kohore prej vitit 2008 deri në vitin 2014 dhe nga kjo arsye gjykata bazuar në nenin 149 të LPK-së vendosi si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e pas analizimit të shkresave të lendës ,duke u bazuar në tarifen e [redacted] dhe dispoziten e nenit 83 të LPK-së e ka detyruar paditësen që përfaqsesit të përkohshëm të të paditurit t’ia paguaj shumën prej 355.68 euro ,në emër të një përfaqsimi 121.68 euro ,hartimit të përgjegjjes në padi 78 euro dhe ankesës 156 euro.


Gjykata po ashtu ka detyruar paditësen që kësaj gjykate t’ia paguaj taksat gjyqësore si në piken tre duke u bazuar në dispozitat që rregullojn qështjen e taksave gjyqësore ,sepse në shkresat e lendës nuk ka prova në lidhje me taksat në fjalë.

Nga arsyet e sipër përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
Më datë 11.02.2016

Gjyqtari

Barin Emërllahu



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

